

UBLIK

Dhoma e Specializuarë të Kosovës
Redaktimet e Dokumentacionit të Seancave Gjyqësore
KSC-BD-44



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Udhëzues Pune i Zyrës Administrative

Mbi Redaktimet e Dokumentacionit të Seancave Gjyqësore

Miratuar nga:	Zyra Administrative, Dhoma e Specializuarë të Kosovës
Data e miratimit:	23 nëntor 2021
Data e hyrjes në fuqi:	23 nëntor 2021
Zëvendëson:	Nuk ka
Numri:	KSC-BD-44

UBLIK

Dhomat e Specializuara të Kosovës
Redaktimet e Dokumentacionit të Seancave Gjyqësore
KSC-BD-44**Përmbajtja**

1.	Qëllimi dhe fushëveprimi	3
2.	Përkufizime	3
3.	Dokumentacioni i seancave gjyqësore	4
	A. Redaktimet gjatë seancave	4
	B. Redaktimet pas seancës	5

UBLIK

Dhoma e Specializuar të Kosovës
Redaktimet e Dokumentacionit të Seancave Gjyqësore
KSC-BD-44

1. Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1.1. Ky Udhëzues Pune është nxjerrë nga Administratorja në përputhje me nenin 34(1) - (3) të Ligjit për Dhoma e Specializuar dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji Nr. 05/L-053 ("Ligji") dhe rregullën 23(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").
- 1.2. Udhëzuesi i Punës përcakton procedurat përmes të cilave palët ose pjesëmarrësit mund të kërkojnë redaktimin e informacionit konfidencial të nxjerrë gjatë seancave gjyqësore publike dhe/ose private, dhe zbatimin e mëtejshëm të redaktimeve nga Zyra Administrative.
- 1.3. Procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzues Pune duhet të kuptohen si plotësuese të kompetencës diskreionale të një paneli për të urdhëruar redaktime *proprio motu*.
- 1.4. Redaktimi i dokumentacionit të seancave gjyqësore zbatohet nga Zyra Administrative vetëm pas nxjerrjes së urdhrit për redaktim nga paneli kompetent, siç është saktësuar në Udhëzuesin e Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-15 ("UP për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara").
- 1.5. Ky Udhëzues Pune lexohet së bashku me Qarkoren Informative "Udhëzime mbi Redaktim Digjital", KSC-IC-22. Çdo kërkesë për ndryshimin e masave mbrojtëse të urdhëruara trajtohet në përputhje me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

2. Përkufizime

Përveç përkufizimeve sipas rregullës 2 të Rregullores dhe UP-së për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara, përkufizimet në vijim vlejnë në tërë këtë Udhëzues Pune:

Redaktim	Procedura për heqjen e informacionit konfidencial nga dokumentacioni publik i seancave gjyqësore;
Redaktim gjatë seancës	Redaktim që bëhet në dokumentacionin e seancës gjyqësore brenda periudhës para transmetimit përmes platformës së DHSK-së për transmetim në internet, siç është paraparë me nenin 69(3) të UP-së për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara;
Redaktim pas seancës	Redaktim që bëhet në dokumentacionin e seancës gjyqësore pas transmetimit të seancës përmes platformës së DHSK-së për transmetim në internet, siç është paraparë me nenin 69(3) të UP-së për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara;
Urdhër për redaktim	Urdhri i nxjerrë nga paneli kompetent për redaktimin e informacionit konfidencial

UBLIK

**Dhomat e Specializuara të Kosovës
Redaktimet e Dokumentacionit të Seancave Gjyqësore
KSC-BD-44**

nga dokumentacioni publik i procedurave gjyqësore.

3. Dokumentacioni i seancave gjyqësore

- 3.1. Në pajtim me rregullën 24(1) të Rregullores, dokumentimi i plotë dhe i saktë i çdo seance gjyqësore siç është saktësuar në UP-në për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara përbëhet nga transkriptet dhe incizimet audiovizuale.
- 3.2. Gjithashtu, sipas rastit, Zyra Administrative përpilon versione publike të transkripteve dhe incizimeve audiovizuale, në pajtim me UP-në për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara.
- 3.3. Njësia për Administrimin e Gjykatës ("NJAGJ") e Zyrës Administrative është përgjegjëse për zbatimin e çdo urdhri për redaktim në bashkërendim me njësitë e tjera të Zyrës Administrative.

A. Redaktimet gjatë seancave

- 3.4. Në rastin kur një nga palët/pjesëmarrësit beson se është nxjerrë informacion konfidencial gjatë një seance publike, pala/pjesëmarrësi paralajmëron menjëherë panelin dhe kërkon redaktim. Kërkesa i dërgohet sekretarit të gjykatës me postë elektronike, dhe një kopje për dijeni në adresën e postës elektronike të panelit, ku bëhen të ditura fjalët që duhet të redaktohen me referencat ndaj faqeve përkatëse dhe numrave të rreshtave të transkriptit në kohë reale. Ndryshe, pala/pjesëmarrësi mund të kërkojë nga paneli që të hyjë në seancë private gjatë së cilës të bëjë parashtrim gojor para panelit për të nxjerrë urdhër për redaktim.
- 3.5. Në rastin kur pala/pjesëmarrësi beson se informacioni konfidencial mund të identifikohet nga pamja në incizimet audiovizuale të seancës private, pala/pjesëmarrësi kërkon redaktimin e përmbajtjes vizuale të incizimit audiovizual duke zbatuar procedurën e përcaktuar në paragrafin 3.4 më lart.
- 3.6. Sekretari i gjykatës i NJAGJ-së, sipas udhëzimeve të panelit, është përgjegjës për përgatitjen e versionit të redaktuar konfidencial dhe publik të urdhrit për redaktim, për nënshkrim nga paneli.
- 3.7. Sekretari i gjykatës i NJAGJ-së bashkërendon me Njësinë e Teknologjisë së Informacionit ("NJT") për të siguruar zbatimin me kohë të urdhrit për redaktim duke redaktuar informacionin nga transmetimi në internet dhe nga materiali audiovizual publik në të gjitha gjuhët zyrtare.
- 3.8. Në rast se nuk ka kohë të mjaftueshme për të zbatuar urdhrin për redaktim para se të transmetohet përmes faqes së internetit të Dhomave të Specializuara, sekretari i gjykatës i NJAGJ-së e ndal transmetimin në internet për atë segment¹ dhe informon menjëherë panelin. Transmetimi i seancës gjyqësore në faqen e internetit vazhdon nga segmenti vijues.

¹ Me "segment" kuptojmë pjesën e seancës që është i kohëzgjatjes së njëjtë me vonesën me të cilën seanca transmetohet në internet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara. Nëse, për shembull, ndalet segmenti prej orës 09:00 deri në orën 09:45, transmetohet vetëm segmenti vijues, konkretisht, do të transmetohet vetëm seanca nga ora 09:46 deri në orën 10:31.

UBLIK

**Dhoma e Specializuarë të Kosovës
Redaktimet e Dokumentacionit të Seancave Gjyqësore
KSC-BD-44**

- 3.9. Versioni i redaktuar më tej publik i incizimit audiovizual që përfshin redaktimet e zbatuara në përputhje me urdhrin për redaktim mund t'u jepet mediave përmes Njesisë për Informim dhe Komunikim me Publikun ("NJIKP").
- 3.10. Urdhri për redaktim protokollohet nga NJAGJ-ja në pajtim me UP-në për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara më të njëjtën ditë, ose, kur nuk është e mundur, NJAGJ-ja i njofton përmes postës elektronike palët/pjesëmarrësit e pranishëm në sallën e gjyqit për redaktimet e urdhëruara, për të parandaluar përmendjen e mëtejshme të pjesëve të redaktuara të transkriptit.
- 3.11. NJAGJ-ja gjithashtu mundëson që më pas të krijohen versionet e redaktuara më tej publike të transkripteve dhe të incizimeve audiovizuale përkatëse në të gjitha gjuhët zyrtare.

B. Redaktimet pas seancës

- 3.12. Redaktimi i informacionit konfidencial në incizimet audiovizuale publike, që nuk është zbatuar para transmetimit përmes faqes së internetit të Dhomave të Specializuara, përmendur në paragrafin 3.8 më lart, do të zbatohet pas seancës.
- 3.13. Redaktimi i informacionit konfidencial të nxjerrë gjatë seancave publike ose private që as nuk është kërkuar dhe as nuk është urdhëruar gjatë seancës siç është përkrahur në paragrafët 3.4 dhe 3.5 më lart, mund të iniciohet *post facto*.
- 3.14. Pala/pjesëmarrësi kërkuar mund të bëjë parashtrim gojor në seancë private ose të dorëzojë një parashtrim konfidencial me shkrim me kërkesën që të nxirret urdhër për redaktim pas seancës, duke përmendur informacionin e përcaktuar në paragrafin 3.4.
- 3.15. Në rast se mungon koha, pala/pjesëmarrësi mund ta vejë në dijeni sekretarin e gjykatës së NJAGJ-së, duke i dhënë informacionin e nevojshëm të përcaktuar në paragrafin 3.4. Pas kësaj, paneli kompetent vendos mbi kërkesën për redaktim pas seancës.
- 3.16. Pas kërkesës për urdhër për redaktim pas seancës, për të parandaluar nxjerrjen e mëtejshme të informacionit konfidencial, NJAGJ-ja menjëherë:
1. tërheq transkriptet përkatëse në të gjitha gjuhët zyrtare nga Dokumentacioni Gjyqësor Publik në faqen e internetit, dhe
 2. informon palët dhe pjesëmarrësit për redaktimin e mundshëm pas seancës.
- 3.17. Sekretari i gjykatës i NJAGJ-së përgatit versionin e redaktuar konfidencial dhe publik të urdhrit për redaktim pas seancës, që protokollohet në pajtim me UP-në për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara.
- 3.18. Sekretari i Gjykatës NJAGJ-së gjithashtu mundëson që më pas të krijohen versionet e tjera të redaktuara publike të transkriptit dhe të incizimeve audiovizuale përkatëse në të gjitha gjuhët zyrtare.

UBLIK

Dhomat e Specializuara të Kosovës
Redaktimet e Dokumentacionit të Seancave Gjyqësore
KSC-BD-44

Hagë, Holandë
23 nëntor 2021

Dr. Fidelma Donlon
Administratore